

BULETIN

SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE
INVESTIME

RI-ORGANIZIMI I KËSHILLIT

Gjatë muajit të kaluar, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Këshilli Kombëtar është ri-organizuar në aspektin strukturor dhe atë të përgjegjësiave

FAQE 1

AKTIVITETET E SEKRETARIATIT

Gjatë këtij muaji, Sekretariati i KKEI-së ka aktivizuar ueb-faqen e tyre si dhe rrjetet e tjera sociale me qëllim të rritjes së transparencës

FAQE 1

TAKIMI I KËSHILLIT

Takimi i fundit është mbajtur më datën 20 gusht, 2020, ku është prezantuar ri-organizimi i Këshillit si dhe është diskutuar rreth rimëkëmbjes ekonomike

FAQE 2





RI-ORGANIZIMI I KKEI-SË

Ri-organizimi i Këshillit (më parë Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, tani Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime) është bërë në bashkëpunim të ngushtë në mes Sekretariatit të KKEI-së, Kryeministrit dhe kabinetit të tij. Ky ri-organizim përfshin jo vetëm ndryshimin e emrit, mirëpo edhe një ndryshim në fokusin e tij me qëllim të implementimit të praktikave më të mira të Këshillave për Ekonomi dhe Investime, duke synuar konsultime konstruktive, transparente dhe efektive me sektorin privat sa i përket vendim marrjes dhe krijimit të politikave.

Këshilli kryesohet nga Kryeministri i Kosovës dhe qëllimi kryesor është promovimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat në trajtimin e pengesave dhe krijimin e kushteve të favorshme për bizneset në vend. Këshilli ka të drejtë të propozojë strategji të reja, ligjeve dhe rregulloreve, si dhe ndryshime e plotësime të tyre në fushën e zhvillimit ekonomik dhe të nxitjes së investimeve. Për më tepër, monitoron zbatimin e rekomandimeve nga anëtarët dhe palët të interesit

AKTIVITETET

Krahas ri-organizimit, Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime ka bërë rebrandimin e Këshillit duke e ndryshuar emrin, logon si dhe ueb-faqen. Një ndër aktivitetet e vazhdueshme të Sekretariatit të KKEI-së është publikimi i informatave dhe dokumenteve nga takimet dhe aktivitetet e mëparshme në ueb-faqe, me qëllim të krijimit të një qasje të lehtë në informata si dhe rritjes së transparencës.

TAKIMI I PARË I KËSHILLIT TË RI-ORGANIZUAR

Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (KKEI) ka mbajtur takimin e parë, të kryesuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Avdullah Hoti. KKEI u mbajt në format të ri-organizuar, përgatitur dhe mbështetur në terësi nga Sekretariati në aspektin teknik dhe analitik, i cili përkrahet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. KKEI si platformë kyçe për dialog publiko-privat mbledhi Ministrat dhe insitucionet e ndërlidhura me ekonomi dhe investime si dhe përfaqësuesit e asociacioneve të bizneseve, për të diskutuar gjendjen aktuale të bizneseve dhe ekonomisë.

Temë kryesore e këtij takimi ishte rimëkëmbja ekonomike si dhe hapat e nevojshëm që duhet ndërmarrë për lehtësimin e funksionimit të bizneseve gjatë pandemisë. Në fjalën e mbajtur para anëtarëve të Këshillit, Kryeministri i Kosovës z. Avdullah Hoti, njëherit kryesues i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, shprehu falënderimin e tij ndaj BERZH-it për mbështetjen e pakursyer të Sekretariatit të Këshillit i angazhuar në mbledhjen dhe përpunimin e informacioneve sa i përket biznesit dhe ekonomisë në vend. Më tutje, Kryeministri vuri në pah nevojën për bashkëpunim ndërmjet institucioneve publike dhe atyre private në implementimin e pakos së rimëkëmbjes ekonomike si dhe hartimin e draft strategjisë së re zhvillimore për Kosovën në plan afatgjatë.

Përfaqësuesit e ministrive dhe sektorit publik theksuan veprimet e domosdoshme që duhet ndërmarrë gjatë pandemisë, me qëllim të zvogëlimit të pasojave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Po ashtu, përfaqësuesit e asociacioneve të bizneseve shprehën shqetësimet e tyre dhe dhanë rekomandime lidhur me gjendjen e krijuar. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, z. Berat Rukiqi, shprehu shqetësimin për gjendjen në sektorin e turizmit, ndërsa Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, z. Arian Zeka u fokusua ne gjendjen e sektorit të gastronomisë. Për më tepër, ata theksuan se e gjithë kjo situatë përbënë në vete një mundësi për transformimin e ekonomisë nga ajo tradicionale në atë digjitale, rekomandim i cili u mbështet edhe nga Anëtari i Bordit të Këshillit të Investitorëve Evropian, z. Ardian Shehu. Në anën tjetër, Drejtori i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, z. Astrit Panxha propozoi që të ndryshohet ligji për prokurimin publik me qëllim të mbështetjes së prodhuesve vendor. Ndërsa Drejtori i Aleancës së Bizneseve të Kosovës, z. Agim Shahini, propozoi faljen e borxheve dhe ndëshkimeve ndaj bizneseve vendore, si formë e mbështetjes së tyre në këtë situatë të paparë e krijuar si pasojë e pandemisë.

Në fund, znj. Lindita Daija, Udhëheqëse e Sekretariatit të KKEI-së, prezantoi iniciativat e Sekretariatit të KKEI-së lidhur me pakon e rimëkëmbjes, raportet analitike lidhur me ndikimin ekonomik të pandemisë dhe implikimet ligjore. Njëhëkohësisht, znj. Daija prezantoi strukturën e re në bazë të ri-organizimit të KKEI-së.

RAPORTET ANALITIKE

Ekipi i Sekretariatit të KKEI-së ka përfunduar një numër të konsiderueshëm të analizave, duke adresuar prioritetet kryesore të sektorit privat, me fokus në çështjet e ndërlidhura me COVID-19. Gjatë këtij procesi, një numër i madh i palëve të interesit dhe partnerëve janë konsultuar, kështu që çështjet janë analizuar më hollësisht dhe janë ofruar zgjidhjet më të përshtatshme të cilat janë sqaruar, verifikuar dhe i'u janë prezantuar udhëheqësve përkatës të qeverisë.

Sekretariati ka prodhuar dokumente dhe raporte analitike si në vijim:

1. Modelet e masave të propozuara për Qeverinë e Kosovës - Rekomandimet e Sekretariatit të KKEI-së dhe asociacioneve të bizneseve - anëtarëve dhe partnerëve të tjerë të KKEI.
2. Ndikimi Ekonomik i pandemisë COVID-19 në Kosovë.
3. Implikimet ligjore për bizneset - Covid-19.
4. Informacion i qasshëm për të gjitha vendimet e lëshuara nga Qeveria, Ministrinë dhe Autoritetet Publike në lidhje me COVID - 19.
5. Sekretariati draftoi vendimin e qeverisë për krijimin e Grupit të Koordinimit - Covid-19 dhe i sugjeroi anëtarët më aktivë Ministres së Ekonomisë & PTINIS.

Të gjitha raportet janë përgatitur në gjuhë: shqipe dhe angleze. Këto janë ngarkuar në faqen e internetit dhe janë shpërndarë në mediat sociale.

TAKIMET TEKNIKE

Sekretariati i KKEI ka mbajtur takim me Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, z. Vesel Krasniqi, më 21 korrik 2020, ku është diskutuar rreth pasojave të pandemisë në ekonominë e vendit si dhe nevojën për ndryshimin e Ligjeve për Tregti të Brendshme dhe të Jashtme, Ligji për Investime Strategjike, Tregtinë Elektronike, e shumë të tjera. Ministri konsideroi rolin e KKEI-së dhe Sekretariatit të tij në përgjithësi si qenësor për bashkëpunim ndër-institucional dhe në fushat e ndërlidhura me zhvillimin ekonomik. Në fund, të dy palët u pajtuan se krijimi i një strategjie kombëtare për zhvillim ekonomik është vendimtar për ngritjen ekonomike të Kosovës.

Më 26 qershor, Sekretariati i KKEI-së është takuar me Ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, z. Blerim Kuçi. Temat kryesore të diskutuara gjatë këtij takimi ishin të ndërlidhura drejtpërdrejtë për bashkëpunimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit me Sekretariatit të KKEI-së, si dhe rolin dhe angazhimin e Ministrisë përbrenda Këshillit, e posaçërisht në hapat e rimëkëmbjes ekonomike si pasojë e gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19. Të gjitha palët u pajtuan që një Strategji Kombëtare për Zhvillim Ekonomik ka një rëndësi të rritur duke pasur parasysh pasojat me të cilat do të përballet ekonomia e vendit të shkaktuara nga pandemisë.

Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë dhe Sekretariatit, si dhe akterëve të tjerë të rëndësishëm në zhvillimin e Strategjisë, është vendimtare në garantimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse. Hapat e mëtejshëm janë themelimi i një task force përgjegjëse të punoj në pakon e rimëkëmbjes dhe organizimin e një konference të donatorëve në mënyrë që të sigurohen fondet e kësaj pakoje. Ministri po ashtu theksoi rëndësinë e rolit të Sekretariatit të KKEI-së në garantimin e një dialogu përmbajtës dhe gjithëpërfshirës publiko-privat, si dhe zbatimin e praktikave më të mira për zhvillimin ekonomik të vendit.

SEKRETARIATI I



Mbështetur nga



European Bank
for Reconstruction and Development

Shtator, 2020